



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova/ Republika of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš/ Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM DRAGASH



DATE/A:	08/05/2019
REFERENC-Ë	13/277
PËR:	Nxënësit dhe mësimdhënësit e komunës së Dragashit
PËRMES:	Drejtorisë së Arsimit në Dragash
NGA:	MSc. Vloran Cenaj-Drejtore i Arsimit në Dragash
TEMA:	Njoftim

Njoftim

Të nderuar,

Duke u mbështetur në zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.07/63, në zbatimin e vendimit të Qeverisë Për Planin e Veprimit Të Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport Nr.01/86, Marrëveshjes së Bashkëpunimit me MASHT dhe Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Kryetarin e Komunës për Programin Nacional për Rininë, **Ju njoftojmë se me datën 11.05.2019 (të shtunën) mbahen Garat Nacionale të Diturisë në formën e testeve për të gjithë nxënësit nga klasa e I-rë deri në klasën e XII-të në të gjitha shkollat e vendit tonë.**

Duke marrë parasysh që Garat e Diturisë do të mbahen ditën e shtunë më 11.05.2019, atëherë të gjithë punonjësit e arsimit parauniversitar obligohen që këtë ditë të jenë në vendin e tyre të punës.

Gara në Dituri është shtyllë e Programit Nacional për Rininë në kuadër të së cilës do të organizohen gara në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës.

Duke organizuar testin për Garën e Diturisë në të gjitha nivelet e testimit, nxënësit inkurajohen që t'i thellojnë njohuritë e tyre të arritura gjatë shkollimit në nivelet përkatëse.

Në këtë mënyrë hapet rruga e mirë, që të mundësohet kalimi i mësimnxënies, nga niveli teorik në një përvojë aktive, që kërkon qasje logjike ndaj problemeve, përballë të cilave do të ekspozohen nxënësit gjatë testimit.



Me respekt

Drejtoria e Arsimit në Dragash

Drejtore: MSc. Vloran Cenaj